



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR PROJEKTE TË
INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR
NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË
(PIKSH) PËR VITIN 2024**

15 Shkurt, 2024

I. Baza Ligjore

Në zbatim të Ligjit Nr. 80, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit Nr.607, datë 31.08.2016, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)” si dhe të VKM Nr. 75, datë 12.08.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit shpall thirrjen për aplikim për “Projekte të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë” për vitin 2024.

II. Institucionet që kanë të drejtë të aplikojnë

Përmes kësaj thirrjeje do të mbështeten financiarisht projekt-propozime nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë Publik që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre kërkimin shkencor.

III. Kritere të përgjithshme për aplikim

1. Projekt-propozimi duhet të vijë nga një Institucion Publik i Arsimit të Lartë (IAL) ose grup IAL të akredituara, në përputhje me kërkesat e udhëzuesit përkatës të PIKSH (shiko Udhëzuesin për projektet PIKSH);
2. Projekt-propozimi duhet të përmbajë planin për ngritjen ose rinovimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor/laboratoreve të IAL-së, ose planin për blerje të pajisjeve të kërkimit shkencor ku përfshihen, pajisje kryesore ose grupe instrumentesh të kërkimit, koleksione, arkiva ose bazë të dhënash shkencore, sisteme informatike dhe rrjete të komunikimit, si dhe çdo infrastrukturë tjetër kërkimore dhe inovative të një natyre unike, e cila do të shërbejë si për procesin mësimor ashtu edhe atë të kërkimit shkencor në IAL.
3. Projekt-propozimi duhet të përmbajë planin për ta bërë këtë infrastrukturë të aksesueshme dhe të hapur për përdoruesit e jashtëm¹.
4. Infrastruktura e kërkuar duhet të plotësojë kriteret e shkencës së hapur, “open science”, sipas përcaktimeve të ESFRI² (European Strategy Forum on Research and Infrastructures) dhe objektivave startegjike të ERA³.
5. Projekt-propozimi duhet të mbështetet në prioritetet strategjike sektoriale të miratuara nga Qeveria Shqiptare sipas fushave përkatëse.
6. Projekt-propozimi duhet të argumentojë qartë nevojën për të ndërhyrë në infrastrukturën ekzistuese kërkimore shkencore të IAL-së që e propozon, me planin mesimor, kurikulën si dhe planin e kërkimit shkencor të IAL-së.

¹ Burimi i referencës: https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/strategy/european-research-infrastructures_en

² <https://www.esfri.eu/forum>

³ https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/strategy/era_en

7. Projekt-propozimi duhet të argumentojë ndikimin që do të ketë infrastruktura e kërkuar në arritjen e objektivave të politikës, strategjisë dhe misionit të IAL-së;
 8. Projekt-propozimi duhet të argumentojë ndikimin dhe avantazhet që infrastruktura e kërkuar do të ketë në zhvillimin e procesit kërkimor shkencor të IAL-së, lidhur me numrin e përfituesve nga projekti, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë (studentë, pedagogë apo komunitet i kërkimit shkencor, brënda IAL-së që propozon si dhe ndërmjet IAL-ve ose institucioneve që potencialisht mund të përdorin infrastrukturën);
 9. Projekt-propozimi duhet të përshkruajë në mënyrë të detajuar planin e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe të vërtetojë që do ta realizojë atë me burimet e tij financiare dhe njerëzore.
10. Do të kenë përparësi:
- a) Projekt-propozimet që kanë siguruar mbështetje financiare nga burime të tjera siç janë: burime të vetë IAL-së; IAL-ve partnere, biznesit, donatoreve etj.
 - b) Projektet që vijnë si projekt-propozime të dy ose më shumë IAL-ve, për ngritjen e laboratoreve të perbashkta.
 - c) Projekt-propozimet që vijnë në kuadër të mbështetjes së projekteve të studimeve të doktoratës.

IV. Dokumentacioni i kërkuar për aplikim

Aplikantët duhet të dorëzojnë:

1. Shkresë shoqëruese e dosjes së aplikimit firmosur nga titullari i IAL –së.
 2. Format i projekt propozimit i plotësuar sipas udhëzuesit.
- Projekt propozimin i hartuar dhe paraqitur vetëm sipas formularit standard të aplikimit Aneksi 1 “Formati i aplikimit” <http://nasri.gov.al/drejtoria-e-programeve-kombetare2/>).
3. Buxheti i projekt propozimit Aneksi 2 “Forma e propozimit financiar”
 4. Vetëdeklarim i Drejtuesit të projektit që janë shlyer të gjitha detyrimet pranë AKKSHI nëse ka qenë më parë përfitues i fondeve të AKKSHI-së;
 5. Miratimin e titullarit të Institucionit Publik i Arsimit të Lartë për pjesëmarrje në projekt;
 6. Një analizë tregu të bërë për çmimet e paisjeve në kuadër të ngritjes së laboratorit të kërkuar.
 7. CV e Drejtuesit të projektit, i cili duhet të ketë të paktën gradën “Doktor” në fushën përkatëse;
 8. Vendimin e akreditimit të Institucionit Publik i Arsimit të Lartë që aplikon;
 9. Në rastet kur për projekt-propozimin është siguruar bashkëfinancim (IAL, IAL partnere, biznesi, donoret etj), IAL aplikuese duhet të sjellë një evidencë lidhur me bashkëfinancimin (psh një marrëveshje bashkëpunimi midis IAL dhe biznesit).

V. Dorëzimi i aplikimeve

1. Projekt propozimi dhe dokumentacioni i kërkuar sipas udhëzimit, së bashku me shkresën

përcjellëse të titullarit të institucionit, duhet të dorëzohen në AKKSHI, në 2 kopje të shtypura dhe 1 kopje digjitale në CD/USB (dokumentat që janë të firmosura e të vulosura duhen të skanuara. Forma e aplikimit dhe forma financiare të jenë edhe në Word dhe Excel të editueshme).

2. Kopja digjitale duhet të përmbajë:
 - i. Formatin në word të projekt propozimit përfshirë edhe kalendarin e aktiviteteve
 - ii. Formatin në excel të buxhetit të propozuar.
 - iii. Dokumenta të tjera (kopje të origjinalit të futura në dosjen e aplikimit) të jenë vetëm në formatin pdf.
3. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin përmes postës zyrtare, në adresën: AKKSHI, Rruga “Naim Frashëri”, Nr.37, Tiranë, Shqipëri.
4. Afati i fundit për depozitim të aplikimeve në AKKSHI është data **20/03/2024**.

VI. Informacione të tjera

1. Aplikantët duhet t'i referohen udhëzuesit përkatës për PIKSH ku do të gjejnë formën e aplikimit, udhëzime dhe detaje specifike lidhur me plotësimin e dokumentacionit për aplikim.
2. Projekt-propozimet që nuk kanë dokumentacionin e plotë, kanë pasaktësi në plotësimin e formës së aplikimit apo që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në udhëzuesit përkatës, do të skualifikohen në fazën e shqyrtimit administrativ dhe nuk do të kalojnë për vlerësim teknik.
3. Për sqarime më të hollësishme, lidhur me programet ose me procedurat e aplikimit, të interesuarit mund të drejtohen pranë Drejtorisë së Programeve Kombëtare në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ose me e-mail në adresën: gentiana.spahiu@nasri.gov.al deri në datën 10/03/2024.
4. Udhëzuesit dhe Format e aplikimit mund t'i gjeni në faqen zyrtare të AKKSHI: <http://www.nasri.gov.al>.
5. Kalendarin e Thirrjes

Data e publikimit të Thirrjes për aplikim	15 Shkurt 2024
Data e Ditës Informative	21 Shkurt 2024
Afati i fundit për pyetje lidhur me projektin	10 Mars 2024
Afati i fundit për dorëzim të aplikimeve	20 Mars 2024
Afati i fundit i vlerësimit të propozimeve	30 Prill 2024
Shpallja e fitueseve	31 Maj 2024
Nënshkrimi i kontratës	5 Qershor 2024